

AMBASADA AMERIKANE PRISHTINË, KOSOVË

Të dhënat kryesore

KORRIK 2019



Dizajnuet Davis Brody Bond

Arkitekt PAGE

Kontraktor i përgjithshëm BL Harbert
International

Buxheti i përgjithshëm i projektit \$215.5 milion

Informata të përgjithshme


- Ambasada e re ofron platformë të sigurtë, bashkëkohore dhe të qëndrueshme për diplomaci dhe qeverisje.

Dizajni dhe ndërtimi

- Ndërtesa i përmbush standardet e Departamentit të Shtetit për siguri të objekteve, siguri të jetës, qëndrueshmëri dhe ofron një hapësirë afariste bashkëkohore për vizitorët dhe stafin e ambasadës.
- Ndërtesa e posalindur paraqet një prani të re në peisazhin e qytetit të Prishtinës si pikë krenarie për të dy vendet. Lokacioni përfiton nga pamjet kah qendra e qytetit drejt maleve dhe ka burime të natyrshme të dritës dhe nxehtësisë gjatë muajve të ftohtë. Një pellg shumëfunksional që është pjesë e sistemit mekanik shërben si pikë kryesore referimi e peisazhit të kompleksit.
- Në dizajn janë përfshirë hapësira të brendshme dhe të jashtme për ngjarje publike. Këto hapësira shërbejnë si lidhje ndërmjet hapësirës së brendshme dhe të jashtme dhe janë të rëndësishme për jetën e komunitetit.
- Në dizajn janë përfshirë metalet artizanale vendore, që historikisht kanë zënë vend në ndërtim në Kosovë dhe njëkohësisht kanë një pamje bashkëkohore.
- Peisazhi përfshin sheshe dhe oborre për kalimtarë, shfrytëzon topografinë e natyrshme të vendit duke mundësuar qasje të plotë për kalimtarët dhe të ndarë nga mjetet motorike.
- Në ndërtim kanë marrë pjesë përafërsisht rreth 1800 punëtorë – amerikanë, vendorë dhe të vendeve të tjera; duke investuar rreth 6 milionë orë pune dhe duke kontribuar dukshëm në ekonominë e vendit.

Qëndrueshmëria

- Projekti është regjistruar në Këshillin amerikan për ndërtesat e gjelbra për marrjen e çertifikatës si projekt prijës në dizajn të energjisë dhe mjedisit (LEED®) dhe është në garë për çertifikatën e artë LEED®. Kjo çertifikatë merret me inovacion në dizajn, shfrytëzim optimal të energjisë dhe zvogëlim të shfrytëzimit të ujit dhe energjisë.
- Dizajni përfshin mbështjellës dhe qelqëzim të përmirësuar të ndërtesës, hije të jashtme, fuqi të zvogëluar të ndriçimit përmes përdorimit të ndriçimit LED dhe kontrollimit të ndriçimit të natyrshëm dhe ftohësit për ripërtëritjen e ngrohjes që transferon ngrohjen nga mbeturinat në sistemin e ngrohjes të ndërtesës. Çatitë e freskëta dhe me bimësi zvogëlojnë hyrjen e nxehtësisë në ndërtesë dhe nevojën për sistem të kondicionuar të ajrit.
- Sistemi i ngrohjes dhe ftohjes shfrytëzon sistemin e burimit tokësor të shkëmbimit të nxehtësisë të përbërë nga një pellg dhe një fushë vertikale me shtylla, që përmirëson efikasitetin e sistemit në krahasim me sistemet e zakonshme të zbrapjes së nxehtësisë. Kursimi i energjisë pritet të jetë 38 % me një kursim të përgjithshëm të shpenzimeve për energji LEED prej 31 %.
- Kompleksi pritet ta arrijë shkallën "zero" të përdorimit neto të ujit duke baraspeshuar kërkesat për ujë me furnizimin e ujit nga vetë lokacioni, e kjo do të bëhet me vendosjen e rrjetit eficient të ujësjellësit dhe ujitjes, grumbullimit dhe ruajtjes së ujit nga reshjet, si dhe riciklimit të burimeve të ujit dhe të ujrave të zeza në objekt.



Interior



Terrace Art Installation Margo Sawyer, *Synchronicity Spiral*, 2018

Arti

- Koleksioni i përhershëm i artit, i mbikëqyrur nga Zyra e Artit në ambasada, përfshin 25 vepra artistike të punuara në format të ndryshëm – piktura, argjilë, xham, çelik, dru dhe fotografi – të krijuara nga artistë amerikanë dhe kosovarë.
- Të instaluar anëmbanë hapësirave publike të ndërtesës, me këtë koleksion kremtohen lidhjet kulturore ndërmjet Kosovës dhe SHBA-së. Ndër veprat më të veçanta përfshihet vepra artistike e Diana Al Hadidit *Pa titull (Ura e Prizrenit)*, vepër masive e vendosur në mur, që i përshëndet vizitorët sapo të hyjnë në atrium. Kjo vepër shtresë-shtresë, që jep përshtypjen se po pikon, është punuar me material nga lesh-xhami, gips polimeri, suva dhe pigmenti dhe është frymëzuar nga rëndësia e formës dhe kulturore e urës ikonike në Prizren, Kosovë.

- Skulptura Synchronicity Spiral e Margo Sojerit (Margo Sawyer), e punuar me xham të ngjyrosur me dorë dhe 2.7 metra e lartë dhe diametër mbi gjashtë metra, sjell dritë, ngjyrë dhe çast soditjeje në tarracën e ambasadës. Këto punime, si dhe punimet e tjera në koleksion janë dëshmi e aftësisë së artit për të transformuar marrëdhënien ndërmjet individit dhe hapësirës, për të tejkaluar pengesat gjuhësore dhe për të ndërtuar lidhje ndërmjet njerëzve.



Exterior



Art Installation Virginia Scotchie, *Object Maker Series*, 2018

Kontakti

Deb MacLean

Zyrtare për marrëdhënie me publikun

macleanda@state.gov

Christine Foushee

Drejtoreshë për Punë të Jashtme

BYROJA PËR OPERACIONE TË NDËRTIMIT JASHTË VENDIT

FousheeCT@state.gov